

15/10078  
dt 14.04.2009  
Nr. 51/5 Prot.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**MINISTRI**

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Tel: 00.355 4 222 260

1577/1  
Nr. .... Prot.  
Tiranë, më 09.04.2009

**URDHËR**

Nr. 76, datë 09.04.2009

**PËR**

**AKREDITIM ME KUSHT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË DREJTËSI DHE NË FARMACI TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "UNIVERSITETI KRISTAL"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

**URDHËROJ :**

1. Akreditim me kusht të programit të studimit në "Drejtësi", me kohëzgjatje normale 3 vjet dhe me 180 kredite, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e Nivelit të Parë (DNP), në "Drejtësi", e cila njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.
2. Programi i studimit në "Farmaci", të akreditohet me kusht që ai brenda periudhës tremujore nga dalja e këtij urdhri, të riorganizohet në një program studimi të integruar të nivelit të dytë me kohëzgjatje normale 5 vite dhe me 300 kredite, sipas programit të miratuar nga MASH, dhe studentët që kanë përfunduar studimet me programin e studimit trevjeçar (të miratuar sipas modelit të vjetër) ose janë duke i ndjekur ato me këtë program, të plotësojnë formimin e tyre sipas programit të integruar të ciklit të dytë dhe në përfundim të studimeve të marrin një diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë (DIND). Të gjithë studentët e rinj që do të regjistrohen në programin e studimit të Farmacisë nga viti akademik 2009-2010 mund të ndjekin vetëm programin e studimit të integruar të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vite dhe me 300 kredite.
3. Shkolla e lartë private Kristal brenda periudhës tremujore nga dalja e këtij urdhri, duhet të plotësojë kushtin e përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri, në rast mosplotësimi institucioni duhet të nënshtrohet përsëri procesit të vlerësimit dhe akreditimit të parë.



4. Shkolla e lartë private Kristal brenda tre muajve duhet:

- c. Të qartësojë kompetencat e organeve të ndryshme kolegjiale brenda institucionit lidhur me vendimmarrjen për proceset akademike të tij, duke i pasqyruar ato në statut.
- d. Të kryejë transferimin e studenteve në përputhje me rregulloret përkatëse të programeve të studimit (drejtësi, farmaci).
- e. Forma e vlerësimit të studentëve të jetë e tillë që të marrë në konsideratë të gjithë veprimtarinë formuese të lëndës, detyrat e seminarit dhe të parashikohen ato në rregulloren e programit të studimit.
- f. Të mos kryej mësimdhënie në filialin e Fierit për sa kohë nuk është i licencuar për të ofruar këtë program.
- g. Të përputhë strukturën mësimore faktike me planin mësimor.

5. Pas përfundimit të afatit tremujor, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë të bëjë verifikimin e plotësimeve të përcaktuara në pikën 2 dhe 4 të këtij urdhri, duke i përcjellë raportin përfundimtar me rekomandimet e Këshillit të Akreditimit, Ministrin të Arsimit dhe Shkencës. Pas rekomandimeve Ministri do të vendosë heqjen ose jo të kushtit, për përcaktimet e bëra në pikën 3 dhe 4 të këtij urdhri.


6. Shkolla e lartë private "Kristal" do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programit të studimit në Drejtësi pas 6 vjetësh, sipas përcaktimit në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ai do të nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programit të studimit në Farmaci pas 6 vjetësh, sipas përcaktimit në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, nëse plotëson kushtet e vëna në pikën 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe Shkolla e lartë private "Kristal".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



FATOS BEJA

